

## LIBRI

### **Kadare, President Nderi i Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit**

Shkrimtari ynë i madh, Ismail Kadare do të jetë President Nderi i Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit. Gjatë një takimi në Paris, Drejtoresha e QKLL, Alda Bardhyli ia ka propozuar shkrimtarit këtë rol të rëndësishëm, të cilin ai e ka pranuar, duke dhënë kështu, mbështetjen e tij për shqip. Gjatë kësaj vizite në Paris, drejtorja Bardhyli, ka takuar edhe homologët e saj francezë. Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit do të ketë një partner të rëndësishëm: Qendrën Kombëtare të Librit, në Francë. Një ekip specialistësh nga CNL do t'i asistojnë specialistëve të librit, pranë QKLL, duke marrë nga përvoja e një prej Qendrave më të suksesshme, dedikuar librit. QKLL është institucioni më i ri i varësisë, pranë Ministrisë së Kulturës, që do të orientojë më mirë politikat e MK në drejtim të librit dhe nxitjes së leximit.

## TAKIMI

### **Dita e Radios, Ministria e Kulturës nderon katër personalitete**

Ministria e Kulturës organizoi një aktivitet në nderim të disa figurave që kanë bërë historinë e Radio Tiranës, në Ditën Ndërkombëtare të Radios. Në praninë e një grupi nxënësish të gjimnazit "Petro Nini Luarasi", gazetarja e njohur Zamira Koleci, regjisori e spikeri Xhelil Aliu, inxhinieri i zërit Spiro Konduri dhe gazetarja Rezarta Reçi, ndanë disa nga momentet më të spikatura, përgjatë rrugëtimit të tyre pas mikrofinit të Radio Tiranës. "Mesazhi që ne sot duam t'u japim të rinjve është ai mbi rëndësinë e jashtëzakonshme të lirisë së fjalës dhe t'u tregojmë se si prindërit e tyre arrinin ta gjenin atë përmes valëve të radios. Nga ana tjetër, përmes historisë së këtyre personaliteteve, kuptojmë se ata kanë punuar në grup, kanë qenë si një familje. I vetëm është e pamundur të arrish synimet që i ke vënë vetes", u shpreh Ministria e Kulturës, Elva Margariti, e cila u dorëzoi katër të ftuarve certifikata mirënjohjeje dhe nga një pllakë simbolike.

## KOMISIONI PARLAMENTAR

### **Dëmet e tërmetit, Ministria Margariti raporton masat e para pas 26 nëntorit**

Ministria e Kulturës, Elva Margariti dhe të tjerë përfaqësues të Ministrisë së Kulturës, morën pjesë në një seancë informimi në Komisionin Parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, mbi dëmet e tërmetit të 26 nëntorit 2019, në monumentet e kulturës. Ministria Margariti raportoi hapat e ndërmara menjëherë pas tërmetit, që nga dalja në terren e grupeve teknike, në qarqet Durrës, Tiranë, Shkodër, Lezhë, Dibër, Kukës, Berat, Korçë, Vlorë, Gjirokastrë, te evidentimi i dëmeve dhe nevojave dhe masat e menjëhershme, që u ndërmorën, së pari për të siguruar jetën e qytetarëve dhe më pas për sigurinë e objekteve. Nga 111 objekte të inspektuara, në zonën më të prekur nga tërmeti, 23 rezultuan të papërdorshme dhe 30 pjesërisht të papërdorshme. Në bashkëpunim me Institutin e Ndërtimit u bë edhe vlerësimi i dëmit, që çoi në mbyllje të përkohshme të disa institucioneve kulturore, si Muzeu Historik Kombëtar apo Muzeu i Përgjimeve "Shtëpia me Gjethe". Pas ndërhyrjeve të menjëhershme, këto institucione janë hapur për publikun.

## PROJEKTI

### **BE, ekspertë për ashpërsimin e luftës kundër trafikimit të objekteve kulturore**

Përmirësimi i kuadrit ligjor për lëvizjen e lirë të objekteve kulturore dhe ashpërsimi i luftës kundër trafikimit të paligjshëm të pasurisë sonë kulturore, janë dy nga kërkesat kryesore të Bashkimit Europian. Si një projekt i kësaj të fundit, ka mbërritur në Ministrinë e Kulturës, një grup ekspertësh nga B&S Europe. Përpos ndihmës në qasjen e legjislationit shqiptar me kërkesat e Bashkimit Europian, ekspertët do të kontribuojnë në ngritjen e kapaciteteve teknike e profesionale, në trajnimin e stafit të Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore dhe të institucioneve të tjera, që lidhen në mënyrë direkte e indirekte në trajtimin e kësaj çështjeje, si doganat, policia, zyrat e Interpol-it, prokurorive, etj. Pjesë e këtij projekti është edhe sensibilizimi qytetar për mbrojtjen e trashëgimisë sonë kulturore, duke nisur që nga brezi më i ri, nëpërmjet edukimit përmes kulturës.

## VENDIMI

### **Agim Bajko, Drejtori i ri i Qendrës Kombëtare Kulturore të Fëmijëve**

Më vendim të Këshillit të Ministrave, Drejtori i ri i Qendrës Kombëtare Kulturore të Fëmijëve, u shpall z. Agim Bajko. Propozimi erdhi nga Ministria e Kulturës, e cila arriti në këtë përfundim pas një konkursi të zhvilluar për pozicionin e drejtorit të QKKF. Pas hapjes së thirrjes nga ana e MK, u paraqitën katër kandidatura: Agim Bajko, Monika Lubonja, Fatjon Sulstarova dhe Klajd Ymeri. Pas shqyrtimit të dosjeve të paraqitura, u zhvillua edhe seanca dëgjimore me kandidatët, ku secili prej tyre paraqiti vizionin për të çuar përpara një institucion, që paraqet jo pak vështirësi, si ai i Qendrës së Fëmijëve. Në fund, rezultati i pikëve për secilin kandidat nxori në krye, artistin Agim Bajko, i cili iu paraqiti Ministres së Kulturës, Elva Margariti dhe më pas këshillit të Ministrave. Agim Bajko ka një karrierë të gjatë artistike në skenë dhe në ekran. Përveç roleve të shumta si aktor, për shumë vite ai ka moderuar një nga emisionet më të ndjekura televizive.